V E N D I M
Nr. 578, datë 22.10.2001

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E POLIÇANIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1.Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarëve që preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Poliçanit.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Poliçanit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 2160 m2 tokë arë, në shumën e përgjithshme prej 1 188 000 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e programit të investimeve publike, zëri "Investime për shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike dhe Turizmit.

5. Shpenzimet për realizimin e procedurave të shpronësimit dhe kompensimit të jenë në ngarkim të Bashkisë së Poliçanit, kërkuesit për shpronësim, në shumën 138 000 (njëqind e tridhjet e tetë), lekë.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 10 deri më 30 nëntor 2001.

7. Pagesa e pronarëve të shpronësuar të kryhet nga Bashkia e Poliçanit.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit dhe Prefektura e Qarkut të Beratit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONSËOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE BASHKIA POLIÇAN

Nr	Emri, atësia, mbiemri	Sipërfaqja m2	Çmimi lek/m2	Vlera në lekë
1	Xhaferr Kasem Daja	1080	550	594 000
2	Zerdeli Kasem Kreku	1080	550	594 000
	Shuma	2160		1 188 000